



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

---

**RAPORTI I ZBATIMIT TË REFORMËS SË  
ADMINISTRATËS PUBLIKE:  
PLANI KALIMTAR I VEPRIMIT (PKV) 2021,  
GJATË PERIUDHËS JANAR-QERSHOR 2021**

**MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE**

Tetor 2021, Prishtinë, Kosovë

## Shkurtesat

AB - Auditimi i Brendshëm  
ATK - Administrata Tatimore e Kosovës  
BE - Bashkimi Evropian  
OSHC – Organizatat e Shoqërisë Civile  
DIEKP - Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave  
DK - Dogana e Kosovës  
DMR - Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut  
FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar  
GDPS - Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik  
GKMFP - Grupi Koordinues për Menaxhimin e Financave Publike  
IPSAS - (International Public Sector Accounting Standards) - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik  
KBF - Komisioni për Buxhet dhe Financa  
KASh - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve  
KE - Komisioni Evropian  
KEF – Këshilli Ekonomik dhe Fiskal  
KIP - Komiteti për Investime Publike  
KBFP - Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike  
KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit publik  
LPP - Ligji për Prokurimin Publik  
LMFPP - Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë  
MF - Ministria e Financave  
MFP - Menaxhimi i Financave Publike  
MFPT- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve  
MSA - Marrëveshja e Stabilizim Asocimit  
OB - Organizatat Buxhetore  
PEFA – (Public Expenditure and Financial Accountability) Llogaridhënia e Shpenzimeve dhe Financave Publike  
PIP - Programi i Investimeve Publike  
PVF - Pasqyra Vjetore Financiare  
PPF – (Project Preparation Facility) Projekti Mbështetës për Përgatitjen e Projekteve  
SBS (Sector Budget Support) - Mbështetja Buxhetore Sektoriale  
SIGMA (Support for Improvement in Governance and Management) - Përkrahje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhment)  
SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës  
SNAO – (Swedish National Audit Office) Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë  
SRMFP - Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike  
TI - Teknologjia Informative  
ZKA - Zyra Kombëtare e Auditimit  
ZPS/ZKM - Zyra për Planifikim Strategjik në Zyrën e Kryeministrit  
ZKM - Zyra e Kryeministrit

## PËRMBAJTJA


Shkurtesat.....	2
Përmbledhja ekzekutive .....	4
Pasqyra përmbledhëse.....	6
<i>Tabela 1.- Kartela raportuese e nivelit të rezultateve të Aktiviteteve për PKV 2021, Janar-Qershor 2021 .....</i>	<i>7</i>
Shtylla I: Disiplina Fiskale .....	9
Shtylla II: Efikasiteti Alokues.....	12
Shtylla III: Efikasiteti Operacional.....	13
Shtylla IV: Çështjet Horizontale të MFP.....	16
<i>Tabela 2: Kartela raportuese e zbatimit të Aktiviteteve të PKV 2021, SIPAS Strukturave përgjegjëse .....</i>	<i>18</i>
Sfidat në zbatimin e SRMFP gjatë vitit 2021 .....	20

## Përmbledhja ekzekutive

Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP 2016-2020) është dokumenti kryesor strategjik i reformave në këtë shtyllë. Qeveria e Republikës së Kosovës, përkundër ndikimit negativ të pandemisë Covid19, ka mbetur e përkushtuar në sigurimin e sistemit modern të Menaxhimit të Financave Publike (MFP) që është në harmoni me përvojat më të mira ndërkombëtare dhe mundëson funksionimin efikas dhe efektiv të të gjitha fazave të Menaxhimit të Financave Publike<sup>1</sup>. SRMFP 2016-2020 ka qenë e organizuar rreth 4 shtyllave, që përmbajnë 10 prioritete kyçe të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe 10 indikatorë të suksesit. Pas konsultimeve të strukturave relevante në fushën e reformave në RAP, si dhe propozimin e OECD/SIGMA, është vendosur që strategjitë në kuadër të RAP të harmonizohen për sa i përket shtrirjes kohore. Kështu u vendos që të gjitha strategjitë të sinkronizohen për të mbuluar periudhën kohore 2022-2026. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë si dhe arritjes së zbatimit sa më të madh të aktiviteteve të SRMFP-së, ka vendosur që të hartojë Planin Kalimtar të Veprimit 2021. Për shkak të mungesës së kapaciteteve, situatës me pandeminë si dhe mungesës së Asistencës Teknike, në pjesën e parë të vitit 2021, Grupi Koordinues për Menaxhimin e Financave Publike (GKMFP)<sup>2</sup> ka hartuar Planin Kalimtar të Veprimit për vitin 2021, i cili është aprovuar me Vendim të Ministrit të Financave Punës dhe Transfereve<sup>3</sup>. Plani Kalimtar i Veprimit ishte rezultat i konsultimeve të akterëve relevantë dhe ka qenë i diskutuar me Komisionin Evropian, para se të publikohet në ueb faqen e MFPT. Plani kalimtar përmban katër Shtylla, dhjetë (10) Prioritete, dyzetë (40) aktivitete për vitin 2021, për të siguruar përqendrimin në prioritete për të gjitha fushat prioritare të Reformës në Menaxhimin e Financave Publike edhe pas përfundimit të SRMFP<sup>4</sup>, si dhe zbatimin e aktiviteteve të mbetura pa u zbatuar në vitin 2020.

### **Zbatimi i aktiviteteve të Planit Kalimtar të Veprimit 2021**

Progres i kënaqshëm është raportuar për periudhën gjashtëmujore gjatë vitit 2021, ku nga 40 aktivitetet e planifikuara, janë zbatuar apo janë në zbatim sipas planit 36 aktivitete, apo 90%, ndërsa 4 aktivitetet e mbetura, apo 10%, janë të pa zbatuara apo kanë ngecje.



<sup>1</sup> Shih: SRMFP 2016-2020, e disponueshme në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/FF8DA146-CB8B-4BFD-8DF5-38A1A6162E35.pdf>


<sup>2</sup> Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave Vendimi Nr. 33/2018

<sup>3</sup> <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,117>

<sup>4</sup> Shih: Plani i Rishikuar i Veprimit për periudhën 2019-2020, e disponueshme në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1A893E26-1757-44D9-8538-555CE66C202F.pdf>

### Zbatimi i aktiviteteve sipas Prioriteteve

Për sa i përket performancës së zbatimit të Aktiviteteve sipas Prioriteteve, raporti konstaton se janë tetë prioritete (prioriteti 1, 2, 3, 4, 5, 6, dhe 8) që kanë shkallë të lartë të zbatimit të aktiviteteve në vitin 2021, ku të gjitha aktivitetet janë zbatuar apo janë duke u zbatuar sipas planit. Ndërsa prioritetet 7, 9 dhe 10 kanë aktivitete të planifikuara që kanë vonesa në zbatim. Ky trend pozitiv siguron që në fund të vitit të arrihen caqet e indikatorëve të paraparë në PKV 2021.




### Zbatimi i aktiviteteve sipas Shtyllave

PKV 2021, Prioritetet dhe aktiviteteve e saj i ka të shpërndara në 4 Shtylla si në vijim:


- Shtylla I.- Disiplina Fiskale
- Shtylla II.- Efikasiteti Alokues
- Shtylla III.- Efikasiteti Operacional
- Shtylla IV.- Çështjet horizontale të MFP

Raporti vlerëson trend pozitiv në të gjitha shtyllat (I, II, III dhe IV). Në vijim është paraqitur grafiku lidhur me zbatimin e aktiviteteve sipas katër shtyllave të SRMFP.



### Zbatimi i aktiviteteve sipas strukturave përgjegjëse

Raporti vlerëson gjithashtu trendin e zbatimit të aktiviteteve për 11 strukturat përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve. Në vijim është paraqitur grafiku lidhur me zbatimin e aktiviteteve sipas strukturave përgjegjëse.



### Trendi i arritjes së Indikatorëve

Në këtë periudhë raportuese, nuk mund të vlerësohet zbatimi i 10 Indikatorëve, bazuar në faktin se strukturat përgjegjëse kanë raportuar vetëm për periudhën raportuese janar – qershor 2021.

## Pasqyra përmbledhëse

Raporti gjashtëmujor për zbatimin e SRMFP në periudhën Janar-Qershor 2021 është bazuar në Planin Kalimtar të Veprimit 2021, duke raportuar në nivel të aktiviteteve dhe mundësisht edhe të indikatorëve. Procesi i përgatitjes së këtij raporti gjashtë mujor ka ndjekur procedurat dhe praktikatat e rregullta që MFPT i zbaton. Procesi filloi me mbledhjen e të dhënave nga institucionet përgjegjëse në përputhje me Planin Kalimtar të Veprimit 2021. Konteksti i krijuar me pandeminë e Covid-19 rezultoi me vështirësi të reja për mbledhjen e të dhënave, kështu që platformat online u përdorën për qasje dhe diskutim të të dhënave. Për shkak të rrethanave të vështirësuar dhe mungesës së mbështetjes nga projekti i AT të SBS në MFP, mbledhja e të dhënave përfundoi në fund të Shtatorit 2021, dhe filloi procesi i analizës së kontributeve duke përfshirë rishikimin e raporteve dhe materialeve të tjera relevante. Kjo gjithashtu përfshiu konsultime online me anëtarët e GKMFP, me theks tek anëtarët e strukturave kryesore përgjegjëse për secilin nga 10 prioritetet e SRMFP.

Si rezultat i procesit të analizës së të dhënave, u përgatit drafti fillestar tabelar i raportit, në përputhje me manualin e rishikuar dhe aprovuar në vitin 2020. Hapi i ardhshëm përfshiu filtrimin dhe verifikimin e informatave për të përgatitur Raportin Tabelar Vjetor Janar- Qershor për vitin 2021, i cili siguroi pamjen e përgjithshme, trendin ekzistues dhe bazën për zhvillimin e raportit narrativ. Ngarkesa e punës për MFPT është rritur ndjeshëm si rezultat i Covid-19, veçanërisht në planifikimin dhe zbatimin e politikave për lehtësimin e ndikimit negativ të pandemisë. Për shkak të ndikimit të pandemisë Covid-19, raporti nuk u diskutua me shoqërinë civile, si rezultat i vështirësive logjistike dhe teknike për të akomoduar një proces të tillë.

Si rezultat i zhvillimeve jashtë ndikimit të MFPT, ka pasur vështirësi në koordinimin dhe mobilizimin e institucioneve si në zbatimin e veprimeve të planifikuara ashtu edhe monitorim dhe raportim. Grupi Koordinues i MFP (GKMFP), i ndihmuar nga Sekretariati (DIEKP/MF)

përkundër vështirësive objektive të shkaktuara me Covid19, hartoi Raportin për periudhën Janar-Qershor 2021. GK/MFP, gjithashtu gjatë kësaj periudhe kohore ka përgatitur Raportin Vjetor 2020 mbi zbatimin e SRMFP.

Pavarësisht nga vështirësitë, rezultatet për vitin 2021 në lidhje me zbatimin e Aktiviteteve të planifikuara në SRMFP janë të kënaqshme, me 90% të tyre të zbatuara apo në zbatim sipas planit, dhe 10% të pa zbatuara apo me vonesa serioze. Raporti konkludon trend të kënaqshëm të zbatimit të SRMFP në periudhën kohore Janar-Qershor 2021. Në vijim është prezantuar Kartela raportuese e zbatimit të aktiviteteve gjatë periudhës Janar- Qershor 2021.

**Tabela 1.- Kartela raportuese e nivelit të rezultateve të Aktiviteteve për PKV 2021, Janar-Qershor 2021**

Aktiviteti	ARRITSHMËRIA
	E zbatuar apo në zbatim sipas planit
	E pa zbatuar apo me vonesa serioze
<b>Shtylla 1: Disiplina fiskale</b>	
Prioriteti 1.- Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave	
1.1 Avancimi I modelit makro-ekonomik me qellim të	
1.2 përmirësimit të parashikimit të indikatorëve makro-ekonomik, përfshirë këtu të hyrat	
1.2 Adresimi i rekomandimit të KE-së për hartimin e dokumentit që do të përmbajë opsionet për krijimin e institucionit të pavarur fiskal	
1.3 Ngritja e kapaciteteve të departamentit makro, duke përfshirë trajnime profesionale në vend të punës	
Prioriteti 2.- Kontrollat efektive të zotimeve	
2.1. Monitorimi i vazhdueshëm i certifikimit të pagesave nga OB, me masa efikase të kontrollit siç është paraparë në Rregulloren për shpenzimin e parasë publike	
2.2. Në raportimin vjetor për vitin 2020, i cili aprovohet në mars 2021 do të përfshihet edhe informacioni për: Të farkëtueshmet, Të pagueshmet dhe Asetet, informata këto që mundësojnë që raportimi të tejkalojë kërkesat e IPSAS për parimin e KESH-it	
Prioriteti 3.- Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave	
3.1. Implementimi i Mailston/Inetration 2, qe përfshinë: funksionalizimi i Portalit të Vetëshërbimeve, shërbimet e brendshme, si dhe komponenti i menaxhimit të proceseve të punës (Case managemente functionalities)	
3.2. Zhvillimi dhe aplikimi i procedurave për menaxhimin efikas të borxhit tatimor	
3.3. Zbatimi i aktiviteteve për vitin 2021 të parashikuara në planin e komunikimit të ATK-së për tatimpaguesit	
3.4. Zhvillimi i kontrolleve fizike dhe dokumentare	
3.5. Zhvillimi i kontrolleve post-importuese	
<b>Shtylla 2: Efikasiteti alokues</b>	
Prioriteti 4.- Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor	
4.1. Informimi i Organizatave Buxhetore përmes Instruksioneve (Instruksioni për përgatitjen e KASH, Qarkoreve Buxhetore, etj.) për planifikim sa më real të Buxhetit për secilën OB	
Prioriteti 5.- Transparenca e shpenzimeve publike	
5.1. Publikimi i Informatorit për Qytetarin 2021	

5.2. Publikimi i serive kohore mujore	
5.3. Aprovimi- publikimi i Raportit Vjetor Financiar 2020 të Qeverisë	
<b>Prioriteti 6.- Prokurimi publik eficient dhe transparent</b>	
6.1. Moduli për administrimin e menaxhimit të kontratave publike përmes sistemit të E-prokurimit funksional për të gjitha llojet e kontratave	
6.2. Moduli për vlerësimin e performancës së operatorëve ekonomik/ kontraktorëve në sistemin e E-prokurimit funksional për të gjitha llojet e kontratave	
6.3. Avancimi në hapje të të dhënave të prokurimit publik përmes: - zhvillimit dhe implementimit të ueb-aplikacionit për publikim të të dhënave sipas standardit për të dhëna të hapura, dhe - publikimit të ueb-aplikacionit për përdorim nga të gjitha palët e interesuara.	
6.4. Aprovimi i Ligjit të Ri për PP	
6.5. Zhvillimi dhe aprovimi i legjislacionit dytësor për implementimin e Ligjit të ri të PP	
6.6. Zgjerimi i listës së artikujve për prokurim të centralizuar	
6.7. Përdorimi i moduleve të reja për menaxhim të kontratave të artikujve për vlerësimin e performancës së operatorëve ekonomik/ kontraktorëve dhe për prokurim të centralizuar (AQP)	
<b>Shtylla 3: Efikasiteti Operacional</b>	
<b>Prioriteti 7.- Fuqizimi i auditimit dhe kontrollit të brendshëm</b>	
7.1. Dokumenti i Politikës së KBFP 2022-2025 i zhvilluar dhe i aprovuar nga Qeveria	
7.2. Finalizimi dhe aprovimi i udhëzimit administrativ për certifikimin e AB të sektorit publik.	
7.3. Manuali i MFK i rishikuar dhe i aprovuar	
7.4. Manuali për auditimin e performancës, i finalizuar	
7.5. Edukim i vazhdueshëm profesional në fushën e MFK dhe AB	
7.6. Së paku gjashtë (6) monitorime të kontrollit të brendshëm dhe tetë (8) në auditimin e brendshëm, të realizuara dhe raportet e hartuara	
7.7. Pranimi dhe analiza e pyetësorëve vetë-vlerësues të plotësuar nga SSP për vitin 2020 dhe raportet e auditimit të brendshëm	
<b>Prioriteti 8.- Fuqizimi i auditimit të jashtëm</b>	
8.1. Ndryshimi i ligjit për Auditimin e Përgjithshëm dhe Zyrën e Auditorit Kombëtar	
8.2. Hartimi i udhëzuesit për auditimet e pajtueshmërisë (standalone)	
8.3. Hartimi i udhëzuesit për planifikim strategjik në auditimet e performancës	
8.4. Zhvillimi i bazës së të dhënave për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit.	
<b>Shtylla 4.- Çështjet e ndërlidhura të MFP</b>	
<b>Prioriteti 9.- Përmirësimi dhe ndërveprimi i sistemeve të TI-së</b>	
9.1. Zhvillimi dhe nënshkrimi i Kontratës Kornizë për mirëmbajtje dhe zhvillim të mëtutjeshëm të sistemeve të integruara/ndërlidhura të TI në MF	
9.2. Aprovimi dhe implementimi i Information Security Management System (ISMS)	



9.3. Rishikimi dhe aprovimi i Strategjisë së TI për MF	
9.4. Zhvillimi dhe aplikimi i Tavinës së Shërbimit të TI brenda MF	
Prioriteti 10.- Kapaciteti i ngritur brenda administratës publike për të zhvilluar dhe zbatuar politika në fushën e MFP	
10.1. Plani Kalimtar i Veprimit 2021 për MFP të Qeverisë së Kosovës, i zhvilluar dhe i aprovuar	
10.2. SRMFP 2022-2026 kualitative e zhvilluar dhe e aprovuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës	
10.3. Ngritja e kapaciteteve institucionale të GKMFP në Monitorim dhe Raportim (M&R) të SRMFP	
10.4. Ngritja e kapaciteteve në komunikim të bartësve të SRMFP	

## Shtylla I: Disiplina Fiskale

Shtylla e parë synon të krijojë një kornizë të kujdesshme makroekonomike dhe politikë fiskale me synimin për të forcuar mbikëqyrjen financiare dhe administrimin e rreziqeve fiskale. MFPT vazhdoi të punojë në përfundimin e kornizës afatmesme makro-fiskale dhe eliminimin e rrezikut të paragjyqimeve sistematike në parashikimet e të hyrave. Shtylla e Disiplinës Fiskale përfshinë tre (3) prioritete që kanë të bëjnë me saktësinë e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave, kontrollet efektive të zotimeve dhe mbledhja e qëndrueshme e të hyrave. Gjatë vitit 2021, gjithsej Dhjetë (10) aktivitete janë planifikuar për disiplinën fiskale, dhe gjithsej dhjetë (10) janë zbatuar apo në zbatim e sipër sipas planit ndërsa nuk ka aktivitete që nuk janë duke u zbatuar ose kanë vonesa serioze.

**Në prioritetin e parë,** saktësia e parashikimit të treguesve makroekonomik dhe të të hyrave, raporti vlerëson si në vijim. Nga tre (3) aktivitetet e planifikuara, janë zbatuar të gjitha aktivitetet.

*1.1 Avancimi i modelit makro-ekonomik me qëllim të përmirësimit të parashikimit të indikatorëve makro-ekonomik, përfshirë këtu të hyrat.*

Është avancuar modeli aktual, është punuar në avancim të modelit aktual të "Analiza e qëndrueshmërisë së borxhit" është krijuar modeli për parashikime të bilancit strukturor, si dhe në bashkëpunim me konsulentët e USAID është realizuar 'nowcasting' për BPV-në në baza tremujore.

Do të vazhdohet me avancimin e modeleve ekzistuese si dhe krijimin e nën-modeleve për parashikime makro-fiskale.

*1.2 Adresimi i rekomandimit të KE-së, për hartimin e dokumentit që do të përmbajë opsionet për krijimin e institucionit të pavarur fiskal.* Nuk ka veprime në lidhje me këtë aktivitet.

Me mbështetje financiare nga Drejtoria e Përgjithshme e BE-së për Fqinjësi dhe Negociata të Zgjerimit (DG NEAR) dhe asistencë teknike të Departamentit për Çështje Fiskale të FMN-së, është hartuar dokumenti i opsioneve të institucionit të pavarur fiskal.

Pritet që në konsultim me palët e interesit përfshirë edhe BE-në, të hartohet koncepti i dokumentit për themelimin e këshillit fiskal.

*1.3 Ngritja e kapaciteteve të departamentit makro, duke përfshirë trajnime profesionale në vend të punës.* Gjatë pjesës së parë të vitit 2021 janë mbajtur trajnime të vazhdueshme. Në kuadër të programit me USAID janë mbajtur trajnime nga ana e stafit të Divizionit për 'Young Cells',

në kuadër të aktivitetit “Macrofiscal Training of Trainers”. Gjithashtu punonjësit e njësisë së makros kanë marr pjesë në trajnimet virtuale të organizuara nga JVI dhe CEF. Edhe në të ardhmen pritet të vazhdohet me trajnime të vazhdueshme të stafit të makros.

**Lidhur me prioritetin e dytë**, kontrollin efektiv të zotimeve, raporti vlerëson si në vijim. Nga dy (2) aktivitetet e planifikuara janë zbatuar apo janë në zbatim sipas planit dy (2) aktivitete (aktivitetet 2.1 dhe 2.2) ndërsa nuk ka aktivitete që nuk janë duke u zbatuar ose kanë vonesa serioze.

*2.1 Monitorimi i vazhdueshëm i certifikimit të pagesave nga OB, me masa efikase të kontrollit siç është paraparë në Rregulloren për shpenzimin e parasë publike*

Gjatë gjithë periudhës kohore po monitorohen transaksionet në SIMFK, gjegjësisht shpenzimet e pa certifikuara nga OB-të dhe Divizioni për Monitorim në Thesar ju dërgon OB-ve email në formë të vërejtjes për vonesën në certifikim.

*2.2 Në raportimin vjetor për vitin 2020 i cili aprovohet në mars 2021 do të përfshihen edhe informacioni për: të arkëtueshmet, të pagueshmet, dhe Asetet, informata këto që mundësojnë që raportimi të tejkaloj kërkesat e IPSAS për parimin e kesh-it.*

Raporti Vjeto Financiar 2020 i publikuar në ueb faqen e MFPT përmban edhe aneks raport të veçantë për të arkëtueshmet, detyrimet, asetet kapitale jo financiare, etj.

<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/04E85A56-B508-41C1-A6D6-427A0C091EF0.pdf>

**Tek prioriteti i tretë**, Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave, rezultatet janë si në vijim: Nga katër (4) aktivitetet e planifikuara, janë zbatuar apo janë në zbatim sipas planit katër (4) aktivitete (aktivitetet 3.1, 3.2, 3.3, dhe 3.4), ndërsa nuk ka aktivitete që nuk janë duke u zbatuar ose kanë vonesa serioze.

*3.1 Implementimi i Mailston/Inetration 2, që përfshinë: funksionalizimin i Portalit të vetëshërbimeve, shërbimet e brendshme, si dhe komponenti i menaxhimit të proceseve të punës (Case management functionalities)*

Deri më tani, sa i përket Mailston/Inetration 2, janë dokumentuar proceset e punës për këto module:

- Moduli i Regjistrimit të Bizneseve,
- Moduli i deklarimit dhe pagesës Tatimore,
- Moduli i komunikimit,
- Moduli i Faturës elektronike dhe
- Moduli i menaxhimit të parasë së gatshme:

Të gjitha këto dokumente janë në procesin e aprovimit nga ana e ATK-së, pas komenteve dhe ndryshimeve eventuale.

Gjithashtu për Modulin e Regjistrimit të Bizneseve janë dokumentuar dhe shpalosur rastet e përdorimit që pritet të aprovohen pas komunikimeve të ndërsjella në mes të ATK-së dhe Operatorit Ekonomik.

Bazuar në planin e rishikuar për implementim të Sistemit të Ri të TI-së, Implementimi i Mailston/Inetration 2, pritet të realizohet në periudhën e fund-vitit 2021 dhe në fillim-të vitit 2022.

Hapat e ardhshëm janë:

- Aprovimi i Dokumentit të proceseve të punës, Rasteve të Përdorimit dhe Prototipave,
- Konfigurimi dhe zhvillimet përkatëse dhe
- Testime dhe aprovimet e moduleve funksionale.

Këta hapa planifikohet të përfundohen deri në muajin prill të vitit 2022.

### *3.2 Zhvillim dhe aplikimi i procedurave për menaxhimin e efikas të borxhit tatimor*

Gjatë periudhës raportuese Janar - Qershor 2021 stoku i borxheve të mbledhshëm tatimore ishte 283.7mil EUR, ndërsa borxhi i mbledhur tatimor gjatë periudhës Janar-Qershor 2021 kemi 71.5mil EUR. Krahasuar me vitin paraprak të njëjtën periudhë kemi një rritje mbi 113%. Në të ardhmen do të vazhdohet me hapat si:

- Mundësimi i pagesës së borxhit përmes marrëveshjeve me këste;
- Përgatitja e materialeve informuese për pagesë të borxhit tatimor;
- Trajtimi i hershëm i borxhit tatimor të krijuar.

*3.3 Zbatimi i aktiviteteve për vitin 2021 të parashikuara në planin e komunikimit të ATK-së për tatimpaguesit.* Gjatë periudhës raportuese Janar-Qershor 2021 Administrata Tatimore e Kosovës, në vazhdimësi është e përkushtuar që të gjithë tatimpaguesve t'u siguroj, Edukimin, Informimin dhe lehtësimin e procedurave, përmes ofrimit të shërbimeve profesionale, transparente dhe efikase konform Legjislacionit Tatimor. Pra, me qëllim të informimit të tatimpaguesve për përmbushjen e detyrimeve tatimore. ATK gjatë periudhës raportuese të lartshënuar, ka ofruar shërbimet, si në vijim:

- 122,366 Tatimpagues të regjistruar në Sistemin Elektronik EDI,
- 1,364,634 shërbime elektronike të ofruara – deklarime përmes EDI,
- 1,424 përgjigje për tatimpagues (fizike dhe elektronike),
- 1,172 rregullime dhe përgjigje përmes adresës elektronike [edi@atk-ks.org](mailto:edi@atk-ks.org)
- 25 përgatitje të materialeve informuese
- 2 Seminare me tatimpagues
- 8 prezantime për nxënësit e shkollave fillore/të mesme
- 26 Njoftime/Komunikata për tatimpagues
- 91,726 Shërbime të ofruara për tatimpagues nga Divizioni i Shërbimit dhe Edukimit të tatimpaguesve në ZQ dhe Zyrat e Shërbimit dhe Edukimit nëpër Regjione,
- 37,911 Lëshimi i vërtetimeve elektronike tatimore sipas llojeve të kërkesave
- 5,813 Biznese të reja të regjistruara në Qendrat One Stop Shop

Plani i Komunikimit përcakton mënyrën e komunikimit me tatimpagues, me qëllim të informimit të tyre për zbatimin e drejtë të legjislacionit tatimor. Për rritjen e përmbushjes vullnetare, Shërbimi i Tatimpaguesve, vazhdimisht do t'u bëjë të qartë tatimpaguesve se pagesa e tatimit është e nevojshme për funksionimin e duhur të shoqërisë, me ç' rast ATK, do të promovohet si autoritet lehtësues që mundëson mbledhjen e të hyrave për aktivitetet e nevojshme të sektorit publik. Të gjitha këto, do të shpien që tatimpaguesit të sigurohen se tatimet janë pjesë e një sistemi që krijojnë privilegje për qytetarët dhe bizneset, në mënyrë të organizuar dhe të efektshme, duke u kujdesur për gjërat që vetë qytetarët apo bizneset në mënyrë individuale nuk do të kishin mundësi që t'i krijonin vetë, si arsimi, shëndetësia, infrastruktura, etj. Në Planin e Trajtimit të Rreziqeve për vitin 2021 do të përfshijë në detaje se kush është dërguesi i mesazhit deri tek tatimpaguesi, çfarë thotë ai mesazh, cilës kategori të bizneseve i takon ai mesazh, në çfarë mënyre do të bëhet informimi për tatimpaguesin, kur do të dërgohet mesazhi, kush është përgjegjës për të implementuar, etj.

### *3.4 Zhvillimi i kontrolleve fizike dhe dokumentare.*

Përgjatë periudhës raportuese në DK janë zhvilluar në total 34,576 kontrolle fizike të mallrave dhe 82,062 kontrolle dokumentare. Në varësi të riskut që paraqesin mallrat në import, ato profilohen për kontroll fizik apo dokumentar.

### *3.5 Zhvillimi i kontrolleve post-importuese.*

Përgjatë periudhës raportuese janë zhvilluar 88 kontrolle post importuese tek subjektet importuese. Kontrollat do të vazhdojnë të aplikohen në varësi të planifikimeve dhe nevojave të paraqitura.

## Shtylla II: Efikasiteti Alokues

Shtylla II synon të sigurojë përdorim efikas dhe efektiv të resurseve të miratuara buxhetore duke forcuar ekzekutimin efikas të buxhetit përmes lidhjes së Strategjisë Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit për tre vitet e ardhshme. Progresi është shënuar në realizimin e aktiviteteve, veçanërisht në besueshmërinë dhe kontrollin e ekzekutimit të buxhetit vjetor. Kjo shtyllë përfshin tre prioritete që kanë të bëjnë me besueshmërinë dhe kontrollin e ekzekutimit të buxhetit vjetor dhe transparenca e shpenzimeve publike. Gjatë vitit 2021, në dy (2) Prioritetet e kësaj shtylle, janë planifikuar gjithsej katër (4) aktivitete për efikasitetin alokues, ku gjithsej katër (4) janë zbatuar apo në zbatim e sipër sipas planit ndërsa nuk ka aktivitete që nuk janë duke u zbatuar ose kanë vonesa serioze.

**Në prioritetin e katërt**, besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor synohet të rritet besueshmëria dhe kontrolli i buxhetit. Raporti vlerëson gjendjen e zbatimit të një (1) aktiviteti të paraparë në këtë prioritet si të zbatuar sipas planit.

### *4.1 Informimi i Organizatave Buxhetore përmes Instruksioneve (Instruksioni për përgatitjen e KASH, Qarkoreve buxhetore, etj.) për planifikim sa me real të Buxhetit për secilin OB*

Në këtë periudhë të raportimit nuk mund të raportohet për këtë objektivë, për realizimin e këtij objektivi mund të raportohet pasi të bëhet mbyllja e vitit fiskal 2021 dhe të publikohen pasqyrat financiare të thesarit në fund të marsit 2022. Sa i përket aktiviteteve të këtij objektivi është lëshuar Instruksioni i KASH-it 2022-2024 dhe janë pranuar materialet prej OB-ve dhe KASH 2022-2024 është aprovuar nga Qeveria me datë 30.04.2021. Është lëshuar Qarkorja 2022/01 për të gjitha Organizatat Buxhetore dhe është pranuar kërkesat buxhetore bazuar në instruksionet e dhëna me Qarkoren buxhetore 2022/01.

Tani jemi në fazën e analizës së kërkesave buxhetore dhe do të mbahen dëgjimet buxhetore të cilat janë planifikuar për muajin shtator dhe do të vazhdohet sipas nevojës për lëshimin e Qarkores buxhetore me kufijtë e fortë buxhetor.

**Në prioritetin e pestë**, transparenca e shpenzimeve publike, Raporti vlerëson gjendjen e zbatimit të aktiviteteve si në vijim. Nga tre (3) aktivitetet e planifikuara, janë zbatuar apo janë në zbatim sipas planit tre (3) aktivitete (aktiviteti 5.1, 5.2 dhe 5.3), ndërsa nuk ka aktivitete në vonesa.

### *5.1 Publikimi i Informatorit për Qytetarin 2021*

Informatori për qytetarin për buxhetin e vitit 2021 është publikuar në ueb faqen e MFPT më datë 17.05.2021 në linkun e mëposhtëm <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,132>.

### *5.2 Publikimi i serive kohore mujore.*

Është përgatitur dhe publikuar në ueb faqen e MFPT raporti mujor- seritë kohore deri në korrik 2021 - <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,125>

### *5.3 Aprovimi- publikimi i Raportit Vjetor Financiar 2020 të Qeverisë*

Është aprovuar RVF 2020 në Qeveri dhe sipas kërkesave ligjore ka shkuar në Kuvendin e Kosovës për miratim dhe po ashtu për auditim tek ZKA.

<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/04E85A56-B508-41C1-A6D6-427A0C091EF0.pdf>

## Shtylla III: Efikasiteti Operacional

Shtylla III Efikasiteti Operacional, përfshin tre (3) prioritete dhe synon përmirësimin e fushës së prokurimit publik, fuqizimin e auditimit dhe kontrollin e brendshëm si dhe fuqizimin e auditimit të jashtëm. Gjatë vitit 2021 janë planifikuar gjithsej tetëmbëdhjetë (18) aktivitete, ku gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) janë zbatuar apo në zbatim e sipër sipas planit ndërsa për një (1) ka vonesa në zbatim.

**Në prioritetin e gjashtë**, prokurimi publik eficient dhe transparent është shënuar rezultat i mirë deri më sot, ku në këtë periudhë të raportimit të gjitha aktivitetet janë duke u zbatuar sipas planit. Zbatimi i aktiviteteve raportohet si në vijim. Nga shtatë (7) aktivitetet e planifikuara janë zbatuar apo janë në zbatim sipas planit që të shtatë (7) aktivitetet.

### *6.1 Moduli për administrimin e menaxhimit të kontratave publike përmes sistemi të e-prokurimit funksional për të gjitha llojet e kontratave.*

KRPP, gjatë kësaj periudhe të raportimit ka vënë në funksion Modulin e Menaxhimit të Kontratave përmes sistemit të prokurimit elektronik. Me këtë Modul bëhet administrimi i implementimit të kontratave nga autoritetet kontraktuese në sistemin e prokurimit elektronik. Me funksionalizimin e këtij moduli do të ngritet efikasiteti, transparenca dhe niveli i llogaridhënies gjatë implementimit të kontratave në prokurimin publik nga të gjitha autoritetet kontraktuese në nivel të vendit dhe për të gjitha llojet e kontratave si dhe do ofrohet në kohë reale një pasqyrë e statusit të implementimit të të gjitha kontratave në fushën e prokurimit publik. KRPP, gjithashtu ka përgatitur video trajnuese elektronike që i udhëzon përdoruesit se si të përdorin këtë Modul nga zyrat apo hapësirat e tyre në çfarëdo kohe.

### *6.2 Moduli për vlerësimin e performancës së operatorëve ekonomik/kontraktorëve në sistemin e e-prokurimit funksional për të gjitha llojet e kontratave.*

KRPP, gjatë kësaj periudhe të raportimit, ka vënë në funksion edhe Modulin për Vlerësimin e performancës së Kontraktorëve përmes sistemit të prokurimit elektronik, që gjithashtu do të ngrit transparencën dhe nivelin e llogaridhënies gjatë implementimit të kontratave në prokurimin publik nga të gjitha autoritetet kontraktuese në nivel të vendit. KRPP, gjithashtu ka përgatitur video trajnuese elektronike që i udhëzon përdoruesit se si të përdorin këtë Modul nga zyrat apo hapësirat e tyre në çfarëdo kohe.

### *6.3 Avancimi në hapje të të dhënave të prokurimit publik përmes:*

- zhvillimit dhe implementimit të ueb-aplikacionit për publikim të të dhënave sipas standardit për të dhënave të hapura, dhe
- publikimit të ueb-aplikacionit për përdorim nga të gjitha palët e interesuara.

KRPP, gjatë kësaj periudhe të raportimit, ka zhvilluar dhe implementuar ueb- aplikacionin <https://opendata.rks-gov.net>, për publikim të të dhënave të hapura në prokurimin publik sipas standardit OCDS (Open Contracting Data Standard), si dhe është bërë publikimi i ueb-aplikacionit për përdorim nga të gjitha palët e interesuara. Të dhënat e prokurimit të publikuara janë plotësisht transparente, të lexueshme dhe në dispozicion për shfrytëzim nga të gjitha palët e interesuara. Më hapjen e të dhënave në prokurimin publik, është rritur transparenca dhe iu është mundësuar dhe lehtësuar në masë të madhe puna organeve të sundimit të ligjit si Zyrës Kombëtare të Auditimit, Agjencisë Kundër Korrupsion dhe çdo palë të interesit që nga zyrat e tyre mund të kenë qasje në të gjitha dokumentet.

### *6.4 Aprovimi i Ligjit të Ri për PP*

Ekipi përgjegjës për draftimin e Ligjit të ri për Prokurim Publik, i formuar nga MFPT, ka përgatitur draftin e parë të Projektligjit për Prokurim Publik (dorëzuar në MFPT nga KRPP me dt. 25.06.2021), i cili do të procedohet më tutje sipas procedurave të parapara për përgatitjen e Projektligjeve.

### *6.5 Zhvillimi dhe aprovimi i legjislacionit dytësor për implementimin e Ligjit të ri të PP*

Me aprovimin e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) të ri nga Kuvendi, KRPP do të përgatit legjislacionin dytësor në fushën e prokurimit publik konform LPP-së ri.

Realizimi i këtij aktiviteti varet nga aprovimi i LPP së ri, nga Kuvendi. Posa të kemi LPP e ri të aprovuar, KRPP do të filloj të bëj draftimin e legjislacionit dytësor në fushën e prokurimit publik.

### *6.6 Zgjerimi i listës së artikujve për prokurim të centralizuar*

Agjencioni Qendror i Prokurimit në afatet e parapara me ligj ka dorëzuar në MFPT propozimin për aprovim të ndryshimit të Listës së artikujve për përdorim të përbashkët. Ky vendim akoma nuk është marr nga ana e Qeverisë, gjë që edhe e kemi paraparë si risk të objektives.

Presim bashkëpunim më të madh me Agjencinë tonë dhe në mes vete nga ana e Qeverisë dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

### *6.7 Përdorimi i moduleve të reja për menaxhim të kontratave të artikujve për vlerësimin e përformancës së operatorëve ekonomik/kontraktorëve dhe për prokurim të centralizuar (AQP)*

Departamenti për Prokurime të Veçanta ka filluar të përdorë Modulin për Menaxhimin e Kontratave në sistemin E-prokurimi, për të gjitha kontratat e nënshkruara pas hyrjes në përdorim të këtij moduli. Kurse për kontratat e centralizuara AQP është duke bashkëpunuar me KRPP për funksionalizimin e modulit të AQP-së që do të lehtësonte zhvillimin dhe do të mundësonte menaxhimin e kontratave të centralizuara. Do të vazhdoj zhvillimi i modulit të AQP-së në platformën e-Prokurimit.

**Në prioritetin e shtatë** - fuqizimi i auditimit dhe kontrollit të brendshëm, është arritur progres në zbatimin e aktiviteteve të parapara. Në këtë periudhë të raportimit zbatimi i aktiviteteve raportohet si në vijim. Nga shtatë (7) aktivitetet e planifikuara janë zbatuar apo janë në zbatim sipas planit gjashtë (6) aktivitetet e planifikuara, ndërsa një (1) aktivitet ka vonesa në zbatim.

### *7.1 Dokumenti i Politikave të KBFP 2022-2025 i zhvilluar dhe i aprovuar nga Qeveria*

Për përgatitjen e Dokumentit të politikave për KBFP 2022-2025 NjQH do të përkrahet nga ekspertët e GIZ-it implementues të projektit të financuar nga BE “Ndihmë teknike për mbështetjen e zbatimit të Reformave për Menaxhimin e Financave Publike në Kosovë - Nr. i kontratës: 2019/413-800”. Gjatë periudhës raportuese NjQH ka vazhduar diskutimet me ekspertët e GIZ-it lidhur me zhvillimin e këtij aktivitet, megjithatë ende nuk kemi filluar me përgatitje e dokumentit meqë ekspertët nga projekti GIZ ende nuk e kanë qartësuar se a do të përgatitet dokumenti i politikave për KBFP apo një strategji për KBFP, e cila do të jetë pjesë e strategjisë së MFP. Për shkak të pandemisë COVID 19 ky aktivitet do të jetë sfidues

### *7.2 Finalizimi dhe aprovimi i udhëzimit administrativ për certifikimin e AB të sektorit publik.*

Për rishikimin e udhëzimit administrativ për certifikim të auditorëve të brendshëm NjQH do të përkrahet nga ekspertët e GIZ-it implementues të projektit të financuar nga BE “Ndihmë teknike për mbështetjen e zbatimit të Reformave për Menaxhimin e Financave Publike në Kosovë - Nr. i kontratës: 2019/413-800”. Gjatë kësaj periudhe raportuese NjQH ka vazhduar diskutimet me ekspertët e GIZ-it lidhur me zhvillimin e këtij aktiviteti. Edhe pse Draft udhëzimi administrativ për certifikim të auditorëve të brendshëm është përgatitur ai ende nuk është finalizuar meqë kemi komente nga projekti. NjQH është dakorduar që për hartimin e këtij udhëzimi të përkrahet nga ekspertët e GIZ-it. Për shkak të pandemisë COVID 19 ky aktivitet do të jetë sfidues.

### *7.3 Manuali i MFK i rishikuar dhe i aprovuar.*

Drafti i manualit të MFK është i përfunduar, pritet vetëm aprovimi.

### *7.4 Manuali për auditimin e performancës, i finalizuar*

Pas përfundimit të dy pilot auditimeve të performancës të cilat janë në proces, do të finalizohet manuali për Auditimin e performancës.

### *7.5 Edukim i vazhdueshëm profesional në fushën e MFK dhe AB.*

1. Në bashkëpunim me IKAP-in në mënyrë virtuale është organizuar trajnimi për 80 pjesëmarrës me temën “ Sigurimi i cilësisë në auditim të brendshëm. Trajnimi;
2. Në bashkëpunim me USAID më 02.03.2021 është organizuar takimi për zhvillimin e pilot auditimeve të performancës. Takimi është organizuar në mënyrë virtuale. Në këtë takim kanë marrë pjesë 15 pjesëmarrës. përcaktimin e objektivave të auditimit të performancës për dy tema: 1.shpenzimet / prokurimi publik dhe të 2. Të hyrat vetanake nga komunat .
3. Gjithashtu, më 29.06.2021 Projekti USAID TEAM në bashkëpunim me Departamentin Qendror Harmonizues (DQH) kanë ndarë me të gjitha Komunat e Kosovës praktikant dhe mekanizmat e zhvilluar në Komunat fokus të Projektit lidhur me proceset e Auditimit të Brendshëm. Gjatë Tryezës, nga DQH janë prezantuar tema lidhur me Sigurimin e cilësisë në Auditimin e Brendshëm dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit, ku u diskutua për objektivat e auditimit, fushëveprimin e auditimit, kontrollin e brendshëm, vlerësimin e rreziqeve për të gjitha sistemet e identifikuara, dokumentojnë vlerësimin e rrezikut, planifikimi i numrit të duhur të auditimeve krahasuar me burimet e auditimit dhe kompetencat e tyre. Kurse nga Projekti USAID TEAM janë prezantuar Listat kontrolluese për raportet e auditimit të brendshëm dhe për aktivitetet e KA përfshirë edhe shabllonin për raportim të KA; nga USAID TEAM Po ashtu janë prezantuar edhe aspekte lidhur me shkaqet për zbatimin e ulët të rekomandimeve të AB. Në tryezë ishin 25 pjesëmarrës. Gjatë muajit Shkurt-2021, u organizuan trajnime në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike me temën "Standardet e menaxhimit dhe raportimit të rrezikut në MFK", ku kanë marrë pjesë 56 SSP. Trajnimet janë zhvilluar në katër sesione me nga 25 zyrtarë në bashkëpunim me IKAP.
4. Krijimi i linkut, qasjeve dhe fjalëkalimeve për 104 OB dhe 19 Ndërmarrjet publike për raportim online nga NJQH/MFK në bashkëpunim me departamentin TI.

### *7.6 Së paku gjashtë (6) monitorime të kontrollit të brendshëm dhe tetë (8) në auditimin e brendshëm, të realizuara dhe raportet e hartuara.*

Për të siguruar cilësinë e MFK gjatë kësaj periudhe raportuese NjQH ishte në proces të monitorimit në katër SSP. (monitorimet janë përfunduar në korrik). Për të siguruar cilësinë gjatë kësaj periudhe raportuese NjQH ishte në proces të monitorimit në katër njësi të auditimit të brendshëm: NjAB në Komunën e Vushtrrisë, Prizrenit Drenasit dhe Dragashit. (monitorimet janë përfunduar në korrik). Për shkak të pandemisë COVID 19 monitorimi do të jetë aktivitet sfidues.

### *7.7 Pranimi dhe analiza e pyetësorëve vetë-vlerësues të plotësuar nga SSP për vitin 2020 dhe raportet e auditimit të brendshëm*

Njësia Qendrore Harmonizuese për Menaxhim Financiar dhe Kontroll (NjQH/MFK) ka pranuar 101 pyetësorë për vetë-vlerësim për vitit 2020 nga gjithsej 104 pyetësorë të shpërndarë në subjekte të sektorit publik. Gjatë periudhës raportuese janë pranuar 82 raporte nga njësitë e



auditimit të brendshëm mbi aktivitetet e zhvilluara në fushën për auditim të brendshëm (15 raporte janë nga njësitë e auditimit të brendshëm nga ndërmarrjet publike).

**Në Prioritetin e tetë,** fuqizimi i auditimit të jashtëm, gjithashtu është arritur progres në zbatimin e aktiviteteve të parapara. Në këtë periudhë të raportimit zbatimi i aktiviteteve raportohet si në vijim. Nga katër (4) aktivitetet e planifikuara janë zbatuar apo janë në zbatim sipas planit që të katër (4) aktivitetet.

#### *8.1 Ndryshimi i ligjit për Auditimin e Përgjithshëm dhe Zyrën e Auditorit Kombëtar.*

Ka pasur një iniciativë Nga Kuvendi i Kosovës dhe janë mbajtur disa takime me Kryetarët dhe Deputetët e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisionit për Buxhet dhe Transfere. Në vazhdim të kësaj Auditori i Përgjithshëm, në maj 2021, i ka dërguar Kuvendit koncept dokumentin në të cilin janë të adresuara nevojat për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit 05/L-055. Janë të paktën dy arsye pse ka nevojë të ndryshohet dhe plotësohet ligji: 1. Heqja e obligimit për auditimin e përvitshëm financiar të të gjitha OB-ve nga ZKA-ja; dhe të eliminohet mundësia që kërkesa buxhetore e ZKA-së të mund të ndryshohet nga Ministria e Financave/ Qeveria. Ndryshimi i parë do të mundësonte aplikimin e qasjes audituese bazuar në rrezik, ndërsa i dyti do të rriste pavarësinë financiare të ZKA-së konform SNISA-ve (Deklarata e Limës dhe Meksikës), duke shmangur ndërhyrjen e mundshme të ekzekutivit. Dokumenti u është dërguar kryetarëve të të dyja komisioneve të lartpërmendura si dhe Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit si dhe për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kundër Korrupsion. Një kopje e dokumentit i është dërguar edhe Kryetarit të Parlamentit dhe Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve. ZKA-ja nuk ka ndonjë informacion kthyes deri tani nëse është ndërmarrë ndonjë veprim.

#### *8.2 Hartimi i udhëzuesit për auditimet e pajtueshmërisë (standalone)*

Udhëzuesi për auditimet e pajtueshmërisë (standalone) është hartuar me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit me Institucionin Suprem të Auditimit të Polonisë.

#### *8.3 Hartimi i udhëzuesit për planifikim strategjik në auditimet e performancës*

Hartimi i Udhëzuesit për planifikim strategjik në auditimet e performancës është në proces të zhvillimit në bashkëpunim me KPMG dhe me mbështetjen e USAID

#### *8.4 Zhvillimi i bazës së të dhënave për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit.*

Baza e të dhënave për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve është zhvilluar me mbështetjen e projektit të binjakëzimit me Institucionin Suprem të Auditimit të Polonisë. Tani është në fazën e vlerësimit Operacional, përshtatshmërisë dhe ndër-komunikimit me sistemin e auditimit SITA dhe ueb faqen e ZKA-së.

## **Shtylla IV: Çështjet Horizontale të MFP**

Shtylla e katërt, çështjet që lidhen me MFP adresohen përmes dy (2) Prioriteteve në SRMFP, përfshirë përmirësimi dhe ndërveprimi i sistemeve të TI-së dhe ngritja e kapaciteteve brenda administratës publike për të zhvilluar dhe zbatuar politika në fushën e MFP. Gjatë vitit 2021 janë planifikuar gjithsej tetë (8) aktivitete, ku pesë (5) aktivitete janë zbatuar apo në zbatim e sipër sipas planit ndërsa tre (3) aktivitete janë të pazbatuara apo kanë vonesa serioze.



**Në prioritetin e nëntë**, përmirësimi dhe ndërveprimi i sistemeve të TI-së, gjatë periudhës raportuese zbatimi i aktiviteteve raportohet si në vijim. Nga katër (4) aktivitetet e planifikuara është zbatuar apo është në zbatim sipas planit tre (3) aktivitete, ndërsa një (1) aktivitet ka vonesa në zbatim.

*9.1 Zhvillimi dhe nënshkrimi i Kontratës Kornizë për mirëmbajtje dhe zhvillim të mëtutjeshëm të sistemeve të integruara/ndërlidhura të TI në MFPT.*

Nuk ka ende ndonjë progres në realizimin e Kontratës Kornizë për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemeve të integruara/ndërlidhura të TI-së në MFPT.

*9.2 Aprovimi dhe implementimi i Information Security Management System (ISMS)*

Janë hartuar politikat (10), procedurat (22), instruksionet (6), formularët (36) dhe ISMS Dokumentet të tjera (Objektivat, Konteksti, Fushëveprimi, etj.).

Në proces është hartimi edhe i një numër dokumenteve të cilat do të përmbushim numrin e dokumenteve të planifikuar për t'u nënshkruar.

*9.3 Rishikimi dhe aprovimi i Strategjisë së TI për MF*

Strategjia është rishikuar dhe është dërguar për komente tek palët e interesit dhe është hartuar Draft Strategjia e TI-së për MFPT. Kjo Strategji është dërguar tek Sekretari i Përgjithshëm i MFPT.

Nënshkrimi i Strategjisë së TI-së për MFPT nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT.

*9.4 Zhvillimi dhe aplikimi i Tavinës së Shërbimit të TI brenda MFPT.*

Është funksionalizuar Tavolina e Shërbimit të TI-së. Është duke funksionuar dhënia e shërbimeve të TI-së brenda MFPT.

Zgjerimi i fushëveprimit të Tavinës së Shërbimeve të TI-së edhe për Sistemet e TI-ve të tjera.

**Në prioritetin e dhjetë**, kapaciteti i ngritur brenda administratës publike për të zhvilluar dhe zbatuar politika në fushën e MFP, gjatë periudhës raportuese zbatimi i aktiviteteve raportohet si në vijim. Nga katër (4) aktivitetet e planifikuara janë zbatuar apo janë në zbatim sipas planit që të dy (2) aktivitetet, ndërsa dy (2) aktivitetet tjera kanë vonesa në zbatim.

*10.1 Plani Kalimtar i Veprimit 2021 për MFP të Qeverisë së Kosovës, i zhvilluar dhe i aprovuar.*

Ky aktivitet është përfunduar në periudhën K1 2021.

*10.2 SRMFP 2022-2026 kualitative e zhvilluar dhe e aprovuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës.*

Ky aktivitetet pritet të përfundohet në periudhën K4.

*10.3 Ngritja e kapaciteteve institucionale të GKMFP në Monitorim dhe Raportim (M&R) të SRMFP.*

Ka vonesa në zbatimin e këtij aktiviteti pasi projekti i BE për mbështetjen e fushës së MFP ka vonesa në mbështetjen e këtij aktiviteti të planifikuar.

*10.4 Ngritja e kapaciteteve në komunikim të bartësve të SRMFP.*

Ka vonesa në zbatimin e këtij aktiviteti pasi projekti i BE për mbështetjen e fushës së MFP ka vonesa në mbështetjen e këtij aktiviteti të planifikuar.

**Tabela 2: Kartela raportuese e zbatimit të Aktiviteteve të PKV 2021, SIPAS Strukturave përgjegjëse**

<b>AKTIVITETI</b>	<b>STATUSI</b>	<b>STRUKTURA PËRGJEGJËSE</b>
<b>Shtylla 1: Disiplina Fiskale</b>		
<b>Prioritet 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave</b>		
1.1 Avancimi i modelit makro-ekonomik me qëllim të përmirësimit të parashikimit të indikatorëve makro-ekonomik, përfshirë këtu të hyrat	Zbatuar	DPMBNF
1.2 Adresimi i rekomandimit të KE-së, për hartimin e dokumentit që do të përmbajë opsionet për krijimin e institucionit të pavarur fiskal	Zbatuar	DPMBNF
1.3 Ngritja e kapaciteteve të departamentit makro, duke përfshirë trajnime profesionale në vend të punës	Zbatuar	DPMBNF
<b>Prioriteti 2: Kontrollat efektive të zotimeve</b>		
2.1 Monitorimi i vazhdueshëm i certifikimit të pagesave nga OB, me masa efektive të kontrollit siç është paraparë në Rregulloren për shpenzimin e parasë publike	Zbatuar	Thesari i Kosovës
2.2 Në raportimin vjetor për vitin 2020 i cili aprovohet në mars 2021, do të përfshihen edhe informacioni për: Të arkëtueshmet, Të pagueshmet, dhe Asetet, informata këto që mundësojnë që raportimi të tejkaloj kërkesat e IPSAS për parimin e KESH-it	Zbatuar	Thesari i Kosovës
<b>Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave</b>		
3.1 Implementimi i Mailston/Inetration 2, që përfshinë: funksionalizimin e Portalit të vetëshërbimeve, shërbimet e brendshme, si dhe komponenti i menaxhimit të proceseve të punës (Case management functionalities)	Zbatuar	ATK
3.2 Zhvillimi dhe aplikimi i procedurave për menaxhimin efikas të borxhit tatimor	Zbatuar	ATK
3.3 Zbatimi i aktiviteteve për vitin 2021 të parashikuara në planin e komunikimit të ATK-së për tatimpaguesit	Zbatuar	ATK
3.4 Zhvillimi i kontrolleve fizike dhe dokumentare	Zbatuar	DK
3.5 Zhvillimi i kontrolleve post-importuese	Zbatuar	DK
<b>Shtylla 2: Efikasiteti alokues</b>		
<b>Prioriteti 4: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor</b>		
4.1 Informimi i Organizatave Buxhetore përmes Instruksioneve (Instruksioni për përgatitjen e KASH, Qarkoreve buxhetore, etj.) për planifikim sa më real të Buxhetit për secilën OB	Zbatuar	DB
<b>Prioriteti 5: Transparenca e shpenzimeve publike</b>		
5.1 Publikimi i Informatorit për Qytetarin 2021	Zbatuar	DB
5.2 Publikimi i serive kohore mujore	Zbatuar	Thesari i Kosovës
5.3 Aprovimi- publikimi i Raportit Vjetor Financiar 2020 të Qeverisë	Zbatuar	Thesari i Kosovës
<b>Prioriteti 6: Prokurimi publik eficient dhe transparent</b>		
6.1 Moduli për administrimin e menaxhimit të kontratave publike përmes sistemit të E-prokurimit funksional për të gjitha llojet e kontratave	Zbatuar	KRPP

6.2 Moduli për vlerësimin e performancës të operatorëve ekonomik/ kontraktorëve në sistemin e E-prokurimit funksional për të gjitha llojet e kontratave	Zbatuar	KRPP
6.3 Avancimi në hapje të të dhënave të prokurimit publik përmes: - zhvillimit dhe implementimit të ueb-aplikacionit për publikim të të dhënave sipas standardit për të dhëna të hapura, dhe - publikimit të ueb-aplikacionit për përdorim nga të gjitha palët e interesuara	Zbatuar	KRPP
6.4 Aprovimi i Ligjit të Ri për PP	Zbatuar	KRPP
6.5 Zhvillimi dhe aprovimi i legjislacionit dytësor për implementimin e Ligjit të ri të PP	Zbatuar	KRPP
6.6 Zgjerimi i listës së artikujve për prokurim të centralizuar	Zbatuar	AQP
6.7 Përdorimi i moduleve të reja për menaxhim të kontratave të artikujve për vlerësimin e performancës së operatorëve ekonomik/ kontraktorëve dhe për prokurim të centralizuar (AQP)	Zbatuar	AQP
<b>Shtylla 3: Efikasiteti operacional</b>		
<b><i>Prioriteti 7: Fuqizimi i auditimit dhe kontrollit të brendshëm</i></b>		
7.1 Dokumenti i Politikës së KBFP 2022-2025, i zhvilluar dhe i aprovuar nga Qeveria	Pa Zbatuar	NJQH
7.2 Finalizimi dhe aprovimi i udhëzimit administrativ për certifikimin e AB të sektorit publik	Zbatuar	NJQH
7.3 Manuali i MFK i rishikuar dhe i aprovuar	Zbatuar	NJQH
7.4 Manuali për Auditimin e performancës i finalizuar	Zbatuar	NJQH
7.5 Edukim i vazhdueshëm profesional në fushën e MFK dhe AB	Zbatuar	NJQH
7.6 Së paku gjashtë (6) monitorime të kontrollit të brendshëm dhe tetë (8) në auditimin e brendshëm, të realizuara dhe raportet e hartuara	Zbatuar	NJQH
7.7 Pranimi dhe analiza e pyetësorëve vetë-vlerësues të plotësuar nga SSP për vitin 2020 dhe raportet e auditimit të brendshëm	Zbatuar	NJQH
<b><i>Prioriteti 8: Fuqizimi i auditimit të jashtëm</i></b>		
8.1 Ndryshimi i ligjit për Auditimin e Përgjithshëm dhe Zyrën e Auditorit Kombëtar	Zbatuar	ZKA
8.2 Hartimi i udhëzuesit për auditimet e pajtueshmërisë (standalone)	Zbatuar	ZKA
8.3 Hartimi i udhëzuesit për planifikim strategjik në auditimet e performancës	Zbatuar	ZKA
8.4 Zhvillimi i bazës së të dhënave për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit	Zbatuar	ZKA
<b>Shtylla 4: Cështjet e ndërlydhura të MFP</b>		
<b><i>Prioriteti 9: Përmirësimi dhe ndërveprimi i sistemeve të TI-së</i></b>		
9.1 Zhvillimi dhe nënshkrimi i Kontratës Kornizë për mirëmbajtje dhe zhvillim të mëtutjeshëm të sistemeve të integruara/ndërlydhura të TI në MF	Pa Zbatuar	DTI

9.2 Aprovimi dhe implementimi i Information Security Management System (ISMS)	Zbatuar	DTI
9.3 Rishikimi dhe aprovimi i Strategjisë së TI për MF	Zbatuar	DTI
<b>Prioriteti 10: Kapaciteti i ngritur brenda administratës publike për të zhvilluar dhe zbatuar politika në fushën e MFP</b>		
10.1 Plani Kalimtar Veprimi 2021 për MFP të Qeverisë së Kosovës, i zhvilluar dhe i aprovuar	Zbatuar	GK MFP/Sekretariati
10.2 SRMFP 2022-2026 kualitative e zhvilluar dhe e aprovuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës	Zbatuar	GK MFP/Sekretariati
10.3 Ngritja e kapaciteteve institucionale të GKMFP në Monitorim dhe Raportim (M&R) të SRMFP	Pa Zbatuar	GK MFP/Sekretariati
10.4 Ngritja e kapaciteteve në komunikim të bartësve të SRMFP	Pa zbatuar	GK MFP/Sekretariati

## Sfidat në zbatimin e SRMFP gjatë vitit 2021

Raporti thekson se shumica e aktiviteteve janë duke u zbatuar në përputhje me planin, ndërsa një numër i vogël po përballen me sfida apo ndalje të zbatimit të tyre. Konkretisht, disa nga sfidat e hasura gjatë zbatimit të reformës janë:

Disa sfida janë evidentuar për shkak të ndikimit negativ shumë dimensional të pandemisë Covid19. Këto ndikime janë manifestuar me pengesa të punës normale institucionale, me ngarkesa institucionale me qëllim të tejkalimit të efekteve të pandemisë, mungesa e përkushtimit institucional, mungesë të mjeteve financiare etj. Po ashtu disa nga aktivitete nuk janë zbatuar ende apo kanë vonesa për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe mungesës së mbështetjes me asistencë teknike.

Në vijim janë disa aktivitete që nuk ka pas mundësi të arrihen:

- Dokumenti i Politikës së KBFP 2022-2025, i zhvilluar dhe i aprovuar nga Qeveria
- Zhvillimi dhe nënshkrimi i Kontratës Kornizë për mirëmbajtje dhe zhvillim të mëtutjeshëm të sistemeve të integruara/ndërlidhura të TI në MF.
- Ngritja e kapaciteteve institucionale të GKMFP në Monitorim dhe Raportim (M&R) të SRMFP.
- Ngritja e kapaciteteve në komunikim të bartësve të SRMFP.

Në analizën e performancës së secilit aktivitet, janë paraqitur hapat e ardhshëm dhe masat që do të ndërmerren, duke marrë parasysh këto sfida me të cilat përballen.